

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Hair Solution Clinic“ sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më datë 05/02/2020 :

**Z. Mario Nucci**, shtetas Italian, lindur ne Foggia( Itali) më 09/10/1974 dhe banues ne Fuggia në adresën Rr. Viale Ignazio d'Adredda,n. 280 Itali, mbajtës i kartes se identitetit me nr.AT5722048,

Dhe **Z. Geant Rraku**, shtetas Shqiptar, lindur ne Tepelene me 11/10/1990 dhe banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. J01011088C

Në cilësinë e “ortakeve themelues“ kane rene dakort per hartimin e ketij akt themelimi , nëpërmjet të cilit deklarojne se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, **“Hair Solution Clinic “ sh.p.k**

**KREU I**

Neni 1  
Krijimi

Shoqëria **“Hair Solution Clinic “ sh.p.k**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Pergjegjësi te Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.


Shoqëria **“Hair Solution Clinic “ sh.p.k.**, është një shoqëri tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka selinë ne adresen Rr. “ Barrikadave“, *Pallati 18, Hyrja 6, Apartamenti 10, Tirane* .Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4  
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do te kryej sherbime mjeksore, trajtime te lekure dhe te flokeve, trajtime te ndryshme mikrokirurgjikale. Shoqëria do te kryej import-eksport. Shoqëria gjithashtu mund te realizoje cdo aktivitet te ligshem tjeter te cilin ajo e cmon te nevojshem per realizimin e qellimeve te saj.



Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II  
KAPITALI

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 10.000(dhjetemije) Lekë. Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 2 kuotë me vlerë, si me poshte:

**Z. Mario Nucci**, zoterues i 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërisë me vlere 5000 (pesemije) lek, qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise.

**Z.Geant Rraku** , zoterues i 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërisë me vlere 5000 (pesemije)lek, qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)  
Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

e)nese ndonjeri prej ortakeve do te shesi kuotat e veta, duhet tu japi prioritet blerjes se ketyre kuotave ortakeve te tjere te shoqerise.

f)miratimi i shitjes se kuotave duhet te behet me vendimin te asambles se ortakeve.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU II  
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm ne rast se shoqëria është e themeluar nga nje ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

*Asambleja e Pergjithshme vendos për çështje si:*

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k)shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.
- o)shitblerja,nenshkrimi i kontributeve dhe dhenia me qera e ndermarrjes apo degeve te ndermarrjes.
- p)Themelimi i shoqerive te cdo tipi, i bashkimit te shoqerive.
- q)Blerja dhe shitja e pjesemarrjeve dhe intereseve te cdo lloji.
- r)Blerja, shitja dhe dhenia me qera e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme te regjistruara.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.



Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Z.Mario Nuccil** emëruar në këtë detyrë për një afat 2 vjecar me të drejtë ripërtëritje.


Administratores emerohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Kompetencat

*Administratori ka të drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) Te hapë llogari bankare dhe te operojë për llogari të kompanisë pa limit.
  - f) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - g) Shoqëria nuk merr përsipër detyrime që lindin nga akte apo veprime juridike të administratorit kur këto nuk janë përmbajtur objektit të veprimtarisë së shoqërisë, ose nuk janë në qëllim të përmbushjes së objektit.
  - h) Administratori nuk ka të drejtë marrje të kredive, garancive, celje të linjave të kredive pranë cdo institucioni financiar, ose ndërmarrje kredie, lidhje e kontratave me objekt operacione financiare/ekonomike, operacione ekonomike dhe financiare të cdo lloji tjetër pa miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
  - i) Administratori duhet të veprojë në përputhje me nenin 98 (detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia) të Ligjit 9901 për Shoqëritë Tregtare.
- Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur :
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
- Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.



Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 12  
Shperndarja ose prishja e shoqërisë

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 13  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14  
Dispozita përfundimtare


Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "**Hair Solution Clinic " sh.p.k** , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.

**ORTAKET E SHOQËRISË**

**Geant Rraku**

Geant Rraku



**Mario Nucci**

MARIO NUCCI

